

C.nr.198/2012

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, (e vendosur në objektin e degës së kësaj gjykate në Vushtrri) si kontestimore e përberë nga gjyqtari individual Faton Ademi, ne qështjen juridikë të paditësit:

nga të cilin e përfaqëson Av. nga
kundër të paditurave: Kompania për Transportimin e Udhëtarëve
“ ”, tani Stacioni i Autobusave të cilën e përfaqëson
dhe Komuna e Komisioni i Aksionërëve,
baza e kontestit: pagimin e të ardhurave personale, pas mbajtjes së seancës kryesore të datës: 02.10.2013, me datën: 28.10.2013 bie këtë:

A K T G J Y K I M

OBLIGOHEN: të paditurat që në mënyrë solidare t'ia paguajnë paditësit në emër të të ardhurave personale shumën prej 604.00 euro për muajt tetor 2010- janar 2011 brenda afatit 7 ditor pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm,

OBLIGOHEN të paditurat që në mënyrë solidare t'ia paguajën paditësit shpenzimet procedurale: në emër tri përsaqësimet nga ana e avokatit shuma prej 405 euro, 104 euro taksa përpilim të padisë, 15 euro taksa për padi, si dhe gjykatës në emër të taksës përpilimit të aktgjykimit shuma prej 15 euro në afat 7 ditor pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm

A r s y e t i m

Paditësi me datën: 11.09.2012 ka parashtruar padi në gjykatë kundër të paditurës së parë për pagesën e të ardhurave personale.

Paditësi në seancën e datës: 17.07.2013 ka bërë zgjerimin e padisë ku si e paditur e dytë është edhe Komuna e - Komisioni i Aksionerëve si organ menaxhues.

E paditura e parë nuk e kundërshtoi kërkesëpadinë e paditësit, mirëpo deklaroi se nuk ka njete financiare për pagesën e këtyre pagave të cilat borxhe janë krijuar gjatë kohës së menaxhimit të kompanisë nga ana e , ndërsa pas privatizimit për shkak të buxhetit të vogël, shpeshëher duhet ndërhyrja e komisionit koniunal të aksionerëve për pagesën e pagave të punëtorëve.

E paditura e dytë nuk mori pjesë në seancë kryesore edhe pse ishte ftuar me rregull.

Në fjalën përfundimitare i autorizuari i paditësit deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, shpenzimet e procedurës i kérkoi sipas Tarifë së Avokatëve.

Gjykata ne shqyrtimin kryesor i administroi këto prova: kontrata e punës e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës, shkresa mbi pranim dorëzimin e dt.20.06.2012.

Pas analizimit dhe çmuarjes se provave te cekura një nga një dhe te gjitha se bashku si dhe rezultatit te krejt procedurës , ashtu siç është përcaktuar me nenin 8 te LPK, gjykata vlerësoi se ne mes te palëve procedurale nuk janë kontestuese këto fakte:

Se paditësi ka qenë në marëdhënie pune te e paditura dhe se e paditura ia ka borxh në emër të të ardhurave personale mjetet e kérkuara, kjo më së miri vërtetohet nga deklarata e përfaqësuesës së të paditurës së parë e cila nuk e kontestoi bazën e kërkesëpadisë, e as lartësinë.

Sipas Ligjit të Procedurës Kontestimore neni 321.2 ku thuhet citoi: "Nuk ka nevojë të provohen faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësorë".

Sa i përket të paditurës së dytë e njëjtë në këtë rast gjëzon edhe legitimacionir pasiv, pasi në bazë të dokumentit të pranim-dorëzimit të datës: 20.06.2012 në paragrafin e dytë përmendet se ndërmarrja në fjalë i dorëzohet Komisionit Komunal të Aksionarëve me asetet dhe obligimet e deritanishme.

Obligimet ndaj paditësit kanë lindur më herët, por të njëjtat sipas paragrafit të lartëcekur janë bartur- kanë kaluar tek menaxhmenti i Rimi konkretisht tek Komisioni i Aksionerëve pranë Komunës së

Sa i përket të drejtës materiale gjykata u bazua në nenin 55 të Ligjit të Punës, ku secilit të punësuar i takon paga në bazë të kontratës së punës, në pajtim me Ligjin e Punës, Kontratën e Përgjithshme Kolektive apo aktin e brendshëm të punëdhënësit.

Në lidhje me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi konform nenit 452 të LPK-së ku thotë se pala e cila humb kontestin është e obliguar që palës kundërshtare t'ia paguan shpenzimet e procedurës. Pala e cila përfaqësohet në seancë nga ana e avokatit, asaj i njihen shpenzimet për angazhimin e avokatit sipas Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës.

Gjykata aktgjykimin e mori duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.198/2012 Datë: 28.10.2013

G J Y Q T A R I
Faton Ademi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në asfat 7 ditor nga data e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.